



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 36-të (e jashtëzakonshme) të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 28. 08. 2020, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Naim Jahiri, anëtar
7. Naim Stullca, anëtar
8. Ramadush Tasholli, anëtar
9. Fatime Krasniqi, anëtare
10. Arif Miftari, anëtar
11. Xhyzide Rustemi, anëtare
12. Lulzim Rustemi, anëtar
13. Ramiz Qeriqi, anëtar
14. Argjent Tasholli, anëtar
15. Nazmi Krasniqi, anëtar
16. Egzona Bytyqi, anëtare
17. Shkelzen Bislimi, anëtar
18. Albulena Kelmendi, anëtare
19. Alban Salihu, anëtar
20. Afrim Miftari, anëtar
21. Hajdin Bytyqi, anëtar
22. Safete Amerllahu, anëtare
23. Bashkim Budakova, anëtar
24. Ukë Kryeziu, anëtar
25. Ganimete Qeriqi, anëtare
26. Manush Shamolli, anëtar
27. Egzona Fazliu, anëtare
28. Arben Salihu, anëtar
29. Fehmi Rexhepi, anëtar

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje, prezentojnë shumica e anëtarëve të Kuvendit, hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se me kërkesë të Kryetarit të komunës kemi thirrë mbledhje të jashtëzakonshme.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

Kryesuesi, vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për, aprovoi rendin e ditës.

REND DITE

1. Propozim Vendim mbi bartjen e rezervës komunale 2020
2. Propozim Vendim mbi Ridestinimin dhe Transferin e mjeteve të Buxhetit për vitin 2020.

I

Propozim Vendim mbi bartjen e rezervës komunale 2020

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadanit, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin

Shkelzen Bislimi, te bujqësia duhet të ipet një shumë më e madhe për shkak të pandemisë. Nuk e dijë a jini duke pritë ndonjë fond prej Qeverisë për ndihmë për bujqit? Po ashtu është një ankesë e bujqëve për anulimin e një konkursi.

Lulzim Rrustemi, ne si grup e kemi shqyrtu këtë propozim vendim dhe në tërësi e përkrahim. Dua një sqarim te Shërbimet Publike, te mallra dhe shërbime për shumën 370 mijë euro. Për bujqësi a do të ketë ndonjë fond shtesë nga qeveria.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, në mungesë të Ligjit të pagave, komunave ju ka dhënë e drejta me i përdorë këto mjete në projektet ekzistuese. Unë kam mendu me i ble 3 auto ambulanca me këto mjete por nuk mu ka leju pasiqë është projekt i ri dhe Ministria na ka udhëzuar që vetëm në projektet e vjetra. Ndarja e 370 mijë eurove te Shërbimet Publike me këtë do të synojmë mirëmbajtjen e rrugëve, heqjen e therrave rreth rrugëve, barit, mirëmbajtjen e lapidarëve, mirëmbajtjen e varrezave etj.

Subvencionet në Bujqësi, pritet të ketë një fond, por dëmtimet e deklaruara nga bujqit në Lipjan janë afër 450 mijë euro. Edhe ne si komunë duhet t'i rrisim subvencionet te bujqësia dhe duhet të dyfishohet numri i serave dhe motokultivatorëve.

Te zyra e Kryetarit po thuaj se shumica e mjeteve po shkojnë për shpenzimet e varrimit. Situatën më të vështirë e kemi te arsimi ku jemi në një situatë që nuk mundet që të parashikoj askush por ne si komunë e kemi bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e mësimi. Po presim edhe ndihmë prej Qeverisë. Por po e shohim mundësinë e pensionimit të parakohshëm të personelit arsimor.

Albulena Kelmendi, prej mjeteve të ndara për arsim më intereson furnizimi me dezinfektues, termomatës dhe maska. Ministria e arsimit i ka parapa tre skenarë e ku skenari i tretë është mësimi online nga shtëpia. Kemi pas nxënës të cilët nuk kanë mundur ta ndjekin mësimin online për shkak të mungesës së paisjeve elektronike. Nuk e dijë a ka parapa komuna staf rezervë për arsim në rast të infektimit të ndonjë mësimdhënësi.

Në arsim nevojiten mjete pasi që në shkollat tona nuk kemi as shampon për pastrimin e duarve. Ne si grup e përkrahim këtë pikë me shpresë që do të ketë edhe ndonjë fond shtesë nga Qeveria.

Ramiz Qeriqi, unë deshta të flas për asfaltimin e rrugëve në Shalë ku rruga "Enver Drenica" ka fillu me u ndërtu por ka mbet në gjysmë. Po ashtu ka qenë një kërkesë e disa familjeve në fshatin Kraishtë për asfaltimin e një rruge nuk e di a është përfshi ajo rrugë. Në pjesën ku banoj unë prapa ABE-së kur po ka të reshura atmosferike nuk po depërton uji pasi që është mbyllur kanali.

Disa fusha sportive po ndërtohen por kisha kërku që të bëhet një kompleks i fushave ndiemëse të shkollave të futbollit.

Hyra Bytyçi, ne si grup e përkrahim këtë propozim vendim, ajo që është me rëndësi që këto mjete do të shpërndahen në projektet e rëndësishme dmth në projektet ekzistuese të cilat edhe do të realizohen. Ndërsa te arsimit tani mësimdhënësit do t'i mësojnë nxënësit online nga shkolla. Urojmë që kjo shumë e mjeteve të realizohet.

Nazmi Krasniqi, problem me u shfrytëzu këto mjete por duhet me i kushtu rëndësi arsimit dhe shëndetësisë. Fillimi i mësimi i vështirë pasi që fëmijët mund ta mbajnë distancën në klasë por jo edhe gjatë rrugës dhe në autobus. Po ashtu do të jetë e vështirë edhe për mësimdhënësit të cilët nuk kanë mundësi për shkak të sëmundjeve të tyre të punojnë sa duhet por duhet të ketë pensionim të parakohshëm.

Fehmi Rexhepi, te arsimit shumë mirë që po diskutohet por ne nuk kemi ujë në shkolla as për t'i pastruar duart.

Në fshatin Medvec nuk është punuar asgjë ku ka disa rrugica të pa shtruara të cilat duhet të asfaltohen po ashtu edhe lumi si dhe duhet të ketë një mbrojtëse te rruga e trenit pasi që qytetarët po jenë të rrezikuar nga treni. Kam edhe një kërkesë që te ZLK-ja të rritet buxheti.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, sa i përket mësimi ne kemi formu një grup një taskforcë ku janë përfshi drejtoresha e arsimit disa drejtor të shkollave më të mëdha dhe një zyrtar i komunës lidhur me fillimin e mësimi.

Janë dizinfektuar të gjitha shkollat po ashtu janë blerë edhe maskat desinfektuesit dhe termomatësit. Nxënësit mund ta mbajnë distancën në shkollë por jo edhe në rrugë edhe në autobus.

Listen rezervë të personelit arsimor e kemi shpallë konkursin.

Ne jemi duke e shiku se sa Laptop dhe kompjuter janë nëpër shkolla.

Ramiz Qeriqi, është mirë që të paktën me fillu mbajtjen e mësimi nga klasa 1 deri në 5.

Imri Ahmeti, ekspertët e arsimit kanë thënë se prioritet do të kenë klasët 1,2,6 dhe 10.

Ne mund t'i ndajmë edhe nga 15 apo edhe 10 nxënës në shkollat nëpër fshatra pasi që kemi hapsirë të mjaftueshme por pak më vështirë do ta kemi në qytet dhe shkolla të mesme. Ne i kemi bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi tha që mund të ketë ndryshime te forma e tabelës pa u prekur shifrat ashtu siq e cekti drejtori pastaj e vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 29 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM

MBI BARTJEN E REZERVES KOMUNALE 2020

Neni 1

Me këtë Propozim Vendim rezervat në buxhetin komunal (paga dhe shtesa) në kategorinë ekonomike(38)fondi burimor (10) në shumë prej 1,311,801.00€ barten në kategoritë tjera ekonomike

Neni 2

Mallra dhe Sherbime

Mjetet nga rezervat në buxhetin komunal

Arsim dhe Shkencë (920) nënprogrami Arsim Fillor (93060)në shumë prej.....734,568.00€
Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale(730), nënprogrami Administrata (73012) në shumë.....4,161.00€
Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale(730),nënprogrami Kujdesi Primar(73200) në shumë.....122,814.00€
Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale(755),nënprogrami Sherbimet Sociale(75511) në shumë..12,278.00€
Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale(755),nënprogrami Sherbimet Sociale(75512) në

shumë10,480.00€

Gjithsej Mallra dhe Sherbime 884,301.00€

Transferohen:

Administrata dhe Personeli (163), nënprog. Administrata (16303) në shumë35,000.00€

Shërbime PublikeMCE(180),nënprog. Infrastrukturës Publike (18163)në shumë..... **370,000.00€**

Shëndetësi dhe MS(730), nënprogrami Kujdesi Primar(73200) në shumë.....150,000.00€

Sherbimet Sociale dhe Rezidenciale (755) nënprogrami Sherbimet Rezidenciale (75512)

në shumë10,480.00€

Arsim dhe Shkencë (920), nënprogrami Administrata (92015) në shumë318,821.00€

Gjithsej Mallra dhe Sherbime 884,301.00€

Subvencione dhe transfere

Mjetet nga rezervat në buxhetin komunal

Arsim dhe Shkencë (920) nënprogrami Arsim Fillor (93060)në shumë113,788.00€

Arsim dhe Shkencë (920) nënprogrami Arsim Mesëm(94260)në shumë 146,212.00€

Gjithësejt Subvencione dhe transfere 260,000.00€

Transferohen:

Zyra e Kryetarit(160), Nënprogrami Zyra e Kryetarit (16003) në shumë20.000.00€

Bujqësia,Pylltaria dhe Zhvillimi Rural(470) nënprogrami Bujqësia (47003).....**130,000.00€**

Shërbime Kulturore(850), nënprogrami Shërbime Kulturore (85003) në shumë.....**90,000.00€**

Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale(730), nënprogrami Administrata (73012)..... 20,000.00€

Gjithsej Subvencione dhe transfere 260,000.00€

Investime Kapitale

Mjetet nga rezervat në buxhetin komunal

Zyra e Kryetarit (160) nënprogrami (16003) në shumë 5,657.00€

Administrata dhe Personeli (163), nënprogrami Administrata (16303) në shumë.....9,195.00€

Inspektimet (166) nënprogrami Inspektimet (16605) në shumë.....365.00€

Prokurimi (167) nënprogrami (16715) në shumë.....7,779.00€

Zyra e Kuvendit Komunal(169) nënprogrami (16903)në shumë1,613.00€

Buxheti(175) nënprogrami (17503) në shumë.....9,867.00€

Shërbime PublikeMCE(180),nënprog. Infrastrukturës Publike (18163) në shumë.....6,279.00€

Shërbime PublikeMCE(180),nënprog. Shërbimet e Zjarrfikësve (18215) në shumë.....518.00€

Zyra Lokale e Komuniteteve(195) nënprogrami (19515) në shumë.....4,314.00€

Bujqësia,Pylltaria dhe zhvillimi Rural(470) nënprogrami Bujqësia (47003).....4,906.00€

Bujqësia,Pylltaria dhe zhvillimi Rural(470) nënprogrami Pylltaria (47083).....10,843.00€

Zhvillimi Ekonomik (480) nënprogrami Planifikimi I Zhvillimit Ekonomik(48003).....12,570.00€

Kadastër dhe Gjeodezi(650) nënprogrami Shërbimet Kadastrale (65015) në shumë.....8,119.00€

Planifikimi Urban dhe Mjedisi(660) nënprogrami Planifikimi Urban dhe Inspekcioni

(66320) në shumë.....7,812.00€

Kultura, Rinia dhe Sportet (850) nënprogrami Sherbimet Kulturore (85003).....8,439.00€

Arsim dhe Shkencë (920) nënprogrami Administrata (92015)në shumë5,691.00€

Arsim dhe Shkencë (920) nënprogrami Arsim Mesëm(94260)në shumë 63,533.00€

Gjithsej pasuri jofinanciare 167,500.00€

Transferohen:

Zyra e Kryetarit(160), nënprogrami Zyra e Kryetarit (16003)

Projekti 89224 Pagesa për vendime gjyqësore në shumë prej20,000.00€

Shërbime Publike.MCE(180),nënprogrami i Infrastrukturës Publike (18163)	
Projekti (44511) Bashkfinacim me donator- në shumë prej.....	50,000.00€
Projekti (47776) Mjetet e dedikuara për shpronsim - në shumë prej	50,000.00€
Projekti (49147) Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadime e Ulët (rruga Mirdita,Rexhep Hashani,Martirët,Shefki Maholli,Gongje Bojaxhiu,Shefradin Tasholli,NënëTereza etj) në shumë prej	7,500.00€
Projekti (49136) Ndërtimi i rrjetit të ndriqimit public përgjat rrugës Lipjan-Magure dhe fshatrat HallaqiI Vogël,Rufc i Ri,Rufc i Vjetër, Torinë, Poturovc, Qylagë,Magure në shumë	<u>40,000.00€</u>
Gjithsej pasuri jofinanciare	167,500.00€

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Neni 4.

Ky Vendim hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës..

Neni 5.

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa, MF-Prishtinë dhe MAPL ndërsa një kopje të ruhet në materialin e Kuvendit.

Shtesë; Vendimi.

III

Propozim Vendim mbi Ridestinimin dhe Transferin e mjeteve të Buxhetit për vitin 2020.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadani, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rustemi, një pjesë e madhe e mjeteve po shkojnë te arsimi është mirë që po ndërtohet shkolla në Gadime po ashtu edhe poligonet e sportit. Kam një kërkesë të banorëve të fshatit Akllap për një rrugicë e cila është prej stacionit të autobusave e deri te varrezat e fshatit. Po ashtu një kërkesë për një rrugicë të banorëve të fshatit Rufc i Vjetër ku janë dikun 11 familje.

Latif Ramadani, në Akllap mund të lidhet një aneks për vazhdimin e asaj rruge pasi që është duke u punuar në disa rrugë tjera në atë fshatë. Ndërsa sa i përket rrugices në Rufc për sivjet nuk kemi buxhet por do ta shohim në vitin e ardhshëm.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 22 votat për aprovoi këtë:

VENDIM

MBI RIDEDESTINIMIN DHE TRANSFERIN E MJETEVE TË BUXHETIT PËR VITIN 2020

Neni 1

Me këtë Propozim Vendim mjetet Ridestinoen dhe Transferohen

Neni 2

**FONDI BURIMOR (10)
INVESTIME KAPITALE :**

Mjetet e mbetura nga projektet :**Tabela 1****Shërbime Publike.MCE(180),Nënprogrami i Infrastrukturës Publike (18163)**

49356 Asfaltimi i rrugëve Shale	13,160.75
47640 Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në qytetin e Lipjanit	5,469.22
49352 Asfaltimi i rrugëve në fshatin Jeta e Re (“Ahmet Delia”Rexhep Stublla)	9,575.46
49365 Asfaltimi i rrugëve në Bujari	8,483.50
49338 Ndertimi i trotuareve me ndriqim publik në Sllovi	4,122.36
49348 Trotualet me ndriqim Publik në Topliqan dhe Grack e Vogel	15,442.50
49332 Asfaltimi i rrugëve në fshatin Akllap(Hamdi Gashi, Bahti Krasniqi, Musli Gashi,etj)	19,384.02
49149 Ndertimi i trotuareve në Babush	3,208.61
49360 Ndertimi i trotuarit me ndriqim publik në Smallushe	11,505.41
49138 Ndertimi i Kanalizimit në fshatin Rubovc i Vogel deri te lumi Sitnica	5,326.10
49369 Asfaltimi i rrugëve në Qallopek	1,348.12
49364 Asfaltimi i rrugëve në Vrelle të Magures	2,000.04
49988 Ndertimi i poligonit sportiv në fshatin Dobraje e Madhe	2,015.55
49334 Asfaltimi i rrugës Gllanice- Torine	3,000.30
49141 Asfaltimi i rrugëve Ribar i Madh (Vehbi Kozhani, Ajet Kozhani, Rrahim Hoti, Beqir Duriqi, Agim Bllaca, Hamdi Hoti etj)	4,000.50
49355 Ndertimi i rrugëve në fshatin Dobraje e Madhe	4,000.06
49155 Asfaltimi i rrugëve në fshatin Poturovc	3,000.36
49345 Asfaltimi i rrugëve në Topliqan (Islam Elshani, Kamer Sylejmani dhe rruga Mbretëria Dardane etj)	5,344.02
49371 Asfaltimi i rrugëve në Bujan	2,000.00
49153 Asfaltimi i rrugëve në fshatin Kraishite(Sylejman Maliqi, Mahallat, Deshmori i Janarit, Rexhep Ballabani, 11 Marsi 1981, etj,	23,963.41
49354 Ndertimi i rrugëve në Lipjan(Anton Qeta,Avdi Avdiu,Mbretresha Teuta,rrugicat që lidhen me rrugën Malet e Sharrit,etj	10,000.00
49366 Asfaltimi i Rrugëve në Resinovec	19,000.00
Gjithsej:	175,350.29

Kultura, Rinia e Sporti (850),Nënprogrami Shërbimet Kulturore (85003) nga projektet:**Tabela 2**

49378 Ndertimi i 5 fushave sportive (Teqe, Kojске,Gllanic, Jeta e re, Qallopek)	20,027.16
Gjithsej:	20,027.16

Arsim dhe Shkencë (920),Nënprogrami i Arsimit parafillor (92250) nga projektet:**Tabela 3**

49151 Riparimi i kulmit në Qerdhe	1,500.00
Gjithsej:	1,500.00

Arsim dhe Shkencë (920),Nënprogrami i Arsimit Fillor (93060) nga projektet**Tabela 4**

47840 Blerja e Inventarit në shkollë	5,500.00
49161 Kabinetet e TIK-ut	10,000.00
Gjithsej:	15,500.00

Totali nga Granti Qeveritar në Kategorinë Investime Kapitale nga tabelat 1,2,3,4 nga fondi burimor (10).....212,377.45€

Mjetet e mbetura nga projektet nga granti qeveritar (10) barten në tabelat 5,6,7 në këto projekte:
Shërbime Publike.MCE(180),Nënprogrami i Infrastrukturës Publike (18163)

Tabela 5

Asfaltimi i rrugicave: Elmi Hasni Glllogovc, rrugica Asdreni , Tomori 1 dhe Tomori 2 Qallapek, Rrugicat ne Banulle faza III, rrugicat ne Janjeve faza III (Projekt i Ri)	65,000.00
Gjithsej:	65,000.00

Arsim dhe Shkencë (920),Nënprogrami i Arsimit Fillor (93060)**Tabela 6**

Rregullimi I Infrastruktures (rrethojave Parkingjeve ne Shkolla) (Projekt I Ri)	37,377.45
Instalimi i Kalldajave dhe rregullimi i nxemjeve qendrore ne Shkollat: Gadime e Ulet , Shale, Poturovc (Projekt i Ri)	15,000.00
Gjithsej:	52,377.45

Arsim dhe Shkencë (920),Nënprogrami i Arsimit Mesem (94260)**Tabela 7**

- Ndertimi I shkolles se mesme Gadime e Eperme (Projekt i Ri)	50.000.00
- Ndertimi I Poligonit sportiv te shkollat e mesme Lipjan (Projekt i Ri)	45,000.00
Gjithsejt:	95,000.00

Totali bartur (10) ne Kategorine Investime Kapitale.....212,377.45€

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Neni 4

Ky Vendim hyn 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës..

Neni 5

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa, MF-Prishtinë dhe MAPL ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Shtesë; Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 1,¹⁵

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi